



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji e gjuhës B 2

Ngarkesa: 1 modul, 4 kredite, 20 orë leksione + 20 orë seminare

Viti /Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndorë: Të bëhet dallimi mes rrafshëve të ndryshme të analizës gjuhësore; të bëhet dallimi mes natyrës dhe funksionit të një njësie gjuhësore; të bëhet dallimi mes vlerës në gjuhë të një njësie gjuhësore dhe funksionimit të saj në ligjërim; të bëhet dallimi mes mënyrës, modalitetit, modalizimit;

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Të identifikohet një formë foljore: formë e thjeshtë, lokucion foljor, perifrazë foljore;
2. Të analizohet një formë foljore në elementet e saj përbërëse: rrënjë+mbaresë kohore-aspektore+mbaresë vetore;
3. Të zotërohen nocionet e kohës dhe aspektit;
4. Të bëhet dallimi mes vlerave kohore, aspekte dhe mënyrore të një foljeje në mënyrën dëftore;
5. Të përligjet përdorimi i lidhore;
6. Të bëhet dallimi mes përdorimeve të ndryshme të një foljeje në paskajore;
7. Të bëhet dallimi mes një pjesoreje të tanishme dhe një mbiemri foljor.